



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 127
Prishtinë, më 6, 7 dhe 13 qershor 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 6, 7 DHE 13 QERSHOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Valbona Dibra, Teuta Sahatqija, Liburn Aliu, Myzejene Selmani, Aurora Bakalli, Blerta Deliu-Kodra, Alma Lama, Gëzim Kelmendi, Halit Krasniqi, Ganimete Musliu dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Albana Gashi parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se deri ku ka arritur procesi i ekzekutimit të aktgjyqimeve të gjykatave kompetente për pagat e papaguara të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.
Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Vjollca Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se cilat janë arsyet që policia nuk është pajisur me uniformat e reja dhe kur parashihet që të ndodh kjo.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjollca Krasniqi.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se cilat kategori të dënuarve do t'i përfshijë Ligji për amnistinë në lirimin prej mbajtjes së dënimit apo ndjekjes penale, a do të amnistohen vetëm serbët për ndjekje lidhur me vepra të caktuara penale?

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se çfarë shërbeu fusnota dhe si mendoni ta zgjidhni situatën lidhur me praninë e përfaqësuesve shtetërorë të Kosovës në samitet me karakter ndërkombëtar, me theks të veçantë në Samitin e Ohrit, i cili ishte paraparë të mbahej në fillim të qershorit?

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se çfarë keni planifikuar të jepni në këmbim të kodit telefonik, në bisedimet të cilat po mbahen me Serbinë, për telekomunikacionin? Pra, kodi që do të kërkonte nga ITU a do të jetë i Kosovës apo i Serbisë?

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albana Fetoshi parashtroi pyetje për ministrin Fadil Ismajli në lidhje me atë se cilët janë aksionarët e ACP Axos, nga vinë paratë për blerjen e Telekomit të Kosovës dhe a do të procedoni me privatizimin e Telekomit të Kosovës pa vendim të Kuvendit?

Ministri Fadil Ismajli iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Fetoshi.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se cili është dokumenti në të cilin janë betuar ministrat dhe zv/ministrat e Kosovës, çfarë dokumenti nënshkruajnë ata në lidhje me besnikërinë që duhet ta tregojnë ndaj shtetit të Kosovës?

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me atë se a ka bërë FSK-ja klasifikimin e dokumenteve zyrtare për FSK-në, dhe mbi çfarë baze janë bërë këto ndarje dhe kur është bërë ky klasifikim?

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Aurora Bakalli parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se a planifikon Ministria e Shëndetësisë të investojë në ndërtimin e spitalit për kryeqytetin?

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputetja Lirije Kajtazi parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me atë se sa i kushtojnë buxhetit të Kosovës largimet e paligjshme të punësuarve në institucionet e Republikës së Kosovës?

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Lirije Kajtazi.

* * *

Në vazhdim në lidhje me pikën e propozuar për rendin e ditës - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës**, kryesuesi Xhavit Haliti theksoi se ministrja

e Tregtisë dhe Industrisë ka kërkuar që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, me arsyetim se ajo gjendet në udhëtim zyrtar jashtë vendit.

Kuvendi miratoi kërkesën e lartpërmendur.

Ndërsa në lidhje me pikën e propozuar për rendin e ditës - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve**, kryesuesi theksoi se kryeministri Hasim Thaçi ka kërkuar që ky projektligj të tërhiqet nga procedurat parlamentare.

Kuvendi miratoi kërkesën e lartpërmendur.

* * *

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për blegtorinë,
5. Propozimi për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
6. Propozimi për zgjedhjen e një anëtar i jo ekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2012,
8. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për vitin 2012,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012,
12. Debat parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015,
13. Debat parlamentar lidhur me ri rregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare të mëparshme

Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 23 dhe 30 maj 2013, pa asnjë vërejtje.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për blegtorinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për blegtorinë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Projektligjin për blegtorinë.

5. Propozimi për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i informoi deputetët se Komisioni i posaçëm, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara me ligj për për zgjedhjen kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur për votim listën e ngushtë me tre (3) kandidatë.

Ndërsa, Kuvendi, prej tre (3) kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, propozon një (1) kandidat, për emërim nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi, më pas i njoftoi deputetët lidhur me procedurat e votimit për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa theksoi se votimi do të jetë i fshehtë.

Sipas nenit 114, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozimi kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

Më tutje, kryesuesi tha se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Fadil Demaku,
2. GP LDK - Afërdita Berisha-Shaqiri,
3. GP Vetëvendosje - Albana Gashi,
4. GP AAK - Time Kadrijaj,
5. GP Koalicioni Kosova e Re - Sevdije Lama,
6. GP SLS - Jelena Bontiq,
7. GP “6+” - Albert Kinolli.

Grupi Parlamentar ZB nuk paraqiti përfaqësues në Komisionin votues.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Fadil Demaku. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 78 deputetë, ndërsa i pavlefshëm është 1 fletëvotim.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Dastid Pallaska ka fituar 35 vota, ndërsa
2. Selvete Gërxhaliu ka fituar 25 vota, dhe
3. Arif Riza ka fituar 17 vota.

Fadil Demaku konstatoi se asnjëri nga kandidatët e lartpërmendur nuk kanë marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Kryesuesi në vazhdim theksoi se pas këtij- procedimi vazhdon si në vijim:

Nga lista e votimit të lartpërmendur hiqet kandidati me më së paku vota të fituara, Arif Riza, ndërsa në raundin e dytë hyjnë në procedurën e votimit kandidatët: Dastid Pallaska dhe Selvete Gërxhaliu.

Rundi i dytë i votimit

Pas numërimit të fletëvotimeve në raundin e dytë, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Fadil Demaku. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 90 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 2 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Dastid Pallaska ka fituar 42 vota, ndërsa
2. Selvete Gërxhaliu ka fituar 46 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit të fshehët në dy runde, Kuvendi

V E N D O S I

1. Kandidatët e propozuar për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Dastid Pallaska, znj. Selvete Gërxhaliu dhe z. Arif Riza, nuk i morën votat e nevojshme për t'u propozuar për emërim nga Presidentja e Republikës së Kosovës.
2. Konkursi publik për zgjedhjen e një (1) anëtari për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, duhet të përsëritet, në pajtim me nenin 6. të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

6. Propozimi për zgjedhjen e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi konstatoi se meqë janë të propozuar tre (3) kandidatë për pozitën e anëtarit jo ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes, votimi do të jetë i fshehtë, ndërsa kandidati duhet të fitojë shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, tha kryesuesi dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Blerta Deliu-Kodra,
2. GP LDK - Afërdita Berisha-Shaqiri,
3. GP Vetëvendosje - Albana Gashi,
4. GP AAK - Time Kadrijaj,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Sevdije Lama,
6. GP SLS - Jelena Bontiq,
7. GP- 6+ Albert Kinolli.

Grupi Parlamentar ZB nuk paraqiti përfaqësues në Komisionin votues.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Afërdita Berisha- Shaqiri.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 69 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 2 fletëvotime. Rezultati i votimit është si në vijim:

Sejdi Rexhepi ka fituar 21 vota,
Arben Dërmaku ka fituar 25 vota, dhe
Driton Balaj ka fituar 21 vota.

Kryesuesi konstatoi se pasi dy kandidatë kanë numër të barabartë të votave të fituara atëherë votimi duhet të përsëritet.

Rundi i dytë i votimit

Pas numërimit të fletëvotimeve në raundin e dytë, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Afërdita Berisha-Shaqiri. Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 70 deputetë, ndërsa i pavlefshëm është 1 fletëvotim.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Sejdi Rexhepi ka fituar 23 vota,
Arben Dërmaku ka fituar 29 vota, dhe
Driton Balaj ka fituar 17 vota.

Kryesuesi në vazhdim theksoi se pas këtij raundi, procedimi vazhdon si në vijim:
Nga lista e votimit të lartpërmendur hiqet kandidati me më së paku vota të fituara, Driton Balaj, ndërsa në raundin e tretë hyjnë në procedurën e votimit kandidatët: Arben Dërmaku dhe Sejdi Rexhepi.

Rundi i tretë i votimit

Pas numërimit të fletëvotimeve në raundin e tretë, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Afërdita Berisha-Shaqiri. Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 65 deputetë ndërsa të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Arben Dërmaku ka fituar 29 vota, ndërsa
2. Sejdi Rexhepi ka fituar 31 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit të fshehtë në tri runde, Kuvendi

V E N D O S I

1. Kandidatët e propozuar për anëtar jo ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës z. Sejdi Rexhepi, z. Arben Dërmaku dhe z. Driton Balaj, nuk i morën votat e nevojshme për t'u emëruar anëtar jo ekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Konkursi publik për zgjedhjen e një (1) anëtari jo ekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, duhet të përsëritet, në pajtim me nenin 38.2. të Ligjit nr. 03/L- 209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2012

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media tha se si Komision kemi shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Xhevahire Izmaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar KKR, Sasha Millosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar "6+", Milivoje Stojanoviq - në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe Time Kadrijaj, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe ministri Mahir Yagcilar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 44,
Kundër-----13,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012.

8. Shqyrtimi i raportit të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2012

Deputeti Behar Selimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion tha se si Komision kemi shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arben Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Burim Ramadani- në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar KKR, si dhe Haki Demolli, Myzejene Selmani, Armend Zemaj dhe Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 33,
Kundër-----25,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2012.

* * *

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare e paralajmëroi për ditën e nesërme, e premte, 7 qershor 2013, në ora 10:00.

Kryesuesi e mbylli mbledhjen plenare në ora 18:20 minuta.

* **

*E premte, më 7 qershor 2013,
Vazhdimi i mbledhjes plenare*

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët: **Xhavit HALITI** dhe **Petar MILETIQ**.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 6 qershor 2013.

Ai procedoi me votim për pikat si në vijim:

9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si Komision kemi shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj- në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Shaip Muja - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hashim Deshishku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar KKR, si dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të hyjmë në procedurën e votimit. Ai procedoi me diskutimet për pikat e radhës.

10. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për vitin 2012

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si Komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës , për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj- në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Burim Ramadani - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar KKR, Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+” si dhe Jakup Krasniqi, Hashim Deshishku dhe Shaip Muja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të hyjmë në procedurën e votimit. Ai procedoi me diskutimet për pikat e radhës.

11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012

Deputeti Ahmet Isufi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës tha se si Komision kemi shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj- në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Fatmir Xhelili - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjollca Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alma Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar KKR, Sasha Millosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviç - në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe Elmi Reçica, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të hyjmë në procedurën e votimit. Ai procedoi me diskutimet për pikat e radhës.

12. Debat parlamentar lidhur me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015

Deputeti Xhevdet Neziraj, i mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015.

Kryesuesi ftoi deputetin Xhevdet Neziraj, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Xhevdet Neziraj, në emër të propozuesit të çështjes fillimisht kritikoi mungesën e ministrave të linjës të Kabinetit qeveritar për debatin e sotëm.

Komuniteti egjiptian është pjesë e rëndësishme e shoqërisë kosovare dhe është i pranuar edhe në Kushtetutën e Kosovës, por edhe me Ligjin për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve, ndërsa kritikoi qasjen në emërtim të tri komuniteteve me shkurtesën RAE, për të konstatuar se komunitet RAE nuk ka, prandaj kjo është një cenim i rëndë i identitetit të komuniteteve.

Strategjia për integrimin e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali të përpiluar nga Këshilli i Evropës, KFOS-i është adaptuar nga Qeveria e Kosovës, do të thotë nuk është produkt i Qeverisë së Kosovës, por është marrë nga Qeveria e Kosovës dhe kjo strategji është strategji e komunitetit rom në Evropën Juglindore dhe vetëm është përkthyer në gjuhën shqipe, janë shtuar edhe dy komunitete tjera dhe për këtë arsye komuniteti egjiptian qysh në fillim e ka kritikuar dhe nuk ka qenë pjesë e kësaj strategjie dhe deri më tani nuk është implementuar asnjë pikë e asaj strategjie.

Në vazhdim ai foli për mungesën e të punësuarve të këtyre komuniteteve me theks të komunitetit egjiptian në ndërmarrjet publike, si në PTK, në KEK dhe në disa ndërmarrje tjera, pastaj për Ministrinë e Planifikimit Hapësinor e cila duhet të bëjë strategjinë për rregullimin e vendbanimeve joformale, si dhe për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, të cilën ministri ai e vlerësoi që nga themelimi si një prej ministrive më kaotike në Qeverinë e Kosovës dhe siç tha ai është e njohur për keq menaxhim, për keqpërdorim.

Unë nuk po kërkoj fond qysh kanë kërkuar serbët në biseda, por po kërkoj që në ato vendbanime ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve mund t'ju ndihmohet në infrastrukturë, në ndërtim dhe rindërtim, theksoi Xhevdet Neziraj.

Më tej deputeti Neziraj kundërshtoi një deklaratë të Këshillit të Evropës sipas së cilës të gjitha këto komunitete i quan “bredhës”.

Komuniteti egjiptian është tradicionalisht në Kosovë, asnjëherë nuk ka qenë endacak, por gjithmonë ka qenë vendës në këto troje, gjithmonë e ka folur këtë gjuhë në të cilën unë sot jam duke iu drejtuar dhe gjithmonë ka pasur tradita dhe zakone shqiptare.

Në fund ai kërkoi nga deputetët që të votohen propozim-rekomandimet, sidomos rekomandimi i parë, që nga strategjia të hiqet komuniteti egjiptian dhe të vazhdojë për këto komunitete tjera. Unë do të gjej forma dhe metoda tjera demokratike me të cilat do të sensibilizohet puna e komunitetit egjiptian në Kosovë, theksoi deputeti Xhevdet Neziraj.

Elmi Reçica, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së tha se ky debat është një moment i veçantë që të gjithë ata që janë përgjegjës dhe të gjithë ata që janë të thirrur, ta marrin shumë më seriozisht, sidomos çështjen e komunitetit egjiptian dhe aspektin e përfaqësimit të tyre në strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015.

Ai në vazhdim theksoi se nuk do të ishte mirë që në propozim-rekomandime të hyjë edhe tërheqja e komunitetit egjiptian nga kjo strategji, por mendoj që ne duhet të insistojmë këtu si Parlament dhe si kolegë dhe si njerëz që Qeveria ta ketë parasysh që komuniteti egjiptian ta gjejë vendin e vet në këtë strategji dhe të fillojë vërtet të cilësohet dhe të trajtohet ashtu çfarë edhe është në realitet.

Në fund ai tha se do të duhej që propozim-rekomandimet të harmonizohen në fund të debatit, por mbi të gjitha do të duhej që brenda strategjisë të theksohet individualiteti i egjiptianëve dhe të komunitetit egjiptian dhe ata të jenë faktikisht pjesë përbërëse e kësaj strategjie, por jo të hiqen ose të ndahen nga kjo strategji.

Armend Zemaj, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së tha se institucionet e Republikës së Kosovës, sidomos ekzekutivi, duhet të jetë përgjegjës ndaj interesave të qytetarëve në realizimin e kushteve dhe të drejtave pa dallim etnie në Kosovë. Kjo nënkupton që të mos ketë dallime në aspektin ekonomik, zhvillimit ekonomik, të punësimit, edukimit e tjerë. Qeveria duhet të jetë më përgjegjëse ndaj këtyre problemeve, në mënyrë që kjo të rezultojë në përmirësimin e gjendjes dhe avancimin e këtyre kërkesave.

Dokumenti i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i njohur si strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, siç thuhet edhe nga arsyeshmëria në paraqitjen e këtij debati, shihet qartë që ka probleme të brendshme, të cilat nëpërmjet debateve dhe propozim-rekomandimeve duhet t'i adresohen Qeverisë.

Si Grup Parlamentar jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe t'i koordinojmë rekomandimet të cilat janë në harmoni me Kushtetutën dhe me ligjet e vendit.

Kërkesa imediate që i adresohet Qeverisë, sidomos institucioneve që janë të krijuara në Zyrën e Kryeministrit, për përmirësimin e gjendjes reale të komunitetit egjiptian, por edhe komuniteteve tjera duhet të jetë prioritet, theksoi në fund deputeti Armend Zemaj.

Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” tha se në vitin 2008 Qeveria e Republikës së Kosovës, ka miratuar strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, në të cilën parashihet promovimi dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe integrimi e tyre në shoqëri. Por, sa janë realizuar qëllimet e kësaj strategjie, na tregon realiteti në të cilin jetojnë dhe problemet me të cilat ballafaqohen këto komunitete sot.

Në vazhdim ajo u fokusua në disa të dhëna statistikore që kanë të bëjnë me numrin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve që ndoqën arsimin fillor dhe të mesëm dhe nivelin e analfabetizmit të këtyre komuniteteve.

Në Kosovë jetojnë mbi 15 mijë ashkali, mbi 11 mijë egjiptianë dhe mbi 8 mijë romë dhe sipas një raporti të bërë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, 40.06% prej tyre kanë të ardhura që nuk e kalojnë shumën prej 80 euro në muaj, që të përkthyer në të hyra për person i bie 0.30 deri në 0.50 cent në ditë.

Në fund Lëvizja “Vetëvendosje”, do t'i përkrahë propozim-rekomandimet të cilat janë propozuar nga deputeti Xhevdet Neziraj dhe propozim-rekomandimet tjera që do të dalin gjatë këtij debati, theksoi deputetja Albana Gashi.

Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fillimisht tha se rasti i komunitetit egjiptian në Kosovë dhe ky debat të cilin e ka ngritur deputeti Neziraj, është rast shumë më specifik për shkak se po flasim për një dokument të Qeverisë së Kosovës që njihet si strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015.

Komuniteti RAE nuk ekziston, nuk është kategori kushtetuese, por është i paraparë si secili komunitet në vete.

Në vazhdim ai theksoi se Grupi Parlamentar i AAK-së pajtohet me propozim-rekomandimet e iniciuara nga deputeti Neziraj dhe besojmë se strategjitë për integrimin e komuniteteve duhet të jenë veç e veç.

Nuk mundemi t'i bashkojmë me një strategji, një dy ose tri komunitete dhe të kemi strategji tjera për komunitetet tjera, tha deputeti Burim Ramadani.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah debatin të cilin e ka iniciuar deputeti Xhevdet Neziraj, për strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, në periudhën 2009-2015.

Në vazhdim ajo u fokusua në rëndësinë e zbatueshmërisë së strategjive dhe ligjeve për të gjitha komunitetet, njëkohësisht edhe për komunitetin egjiptian.

Ndërsa në lidhje me detyrat e ministrive të linjës siç është ajo e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë për Kthim dhe Komunitete si dhe komunat në të cilat jeton komuniteti egjiptian, ajo vlerësoi se nevojitet një vëmendje më e madhe për realizimin e të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarëve të Kosovës, por që edhe komuniteti egjiptian do ta ketë vendin e merituar aty ku ai dëshiron.

Jasmina Zhivković, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se grupi parlamentar që ajo përfaqëson është shumë i interesuar për proceset integruese në Kosovë dhe i mbështet ato me tërë forcën.

Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, për periudhën 2009-2015, paraqet një bazë të mirë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian si dhe për ruajtjen e identitetit të tyre.

Në fund, ajo theksoi se do t'i përkrahë propozim-rekomandimet lidhur me këtë debat.

Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar "6+", tha se do të ishte mirë që debati i sotëm të mbahej në praninë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Implementimi në praktikë i strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, për periudhën 2009-2015, lë mjaft për të dëshiruar.

Në vazhdim ai u fokusua në vështirësitë me të cilat ballafaqohen këto komunitete, me theks tek komuniteti rom, duke potencuar veçmas çështjen e trajtimit mjekësor jashtë vendit dhe çështjen e punësimit për pjesëtarët e këtij komuniteti.

Më pas, ai tha se me gjithë këto vështirësi, ka edhe disa përparime në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetës, çështjes së banimit dhe arsimit dhe për pjesëtarët e këtij komuniteti, në Republikën e Kosovës.

Etem Arifi, në emër të Grupit Parlamentar 'ZB', fillimisht vuri në pah mungesën e Kabinetit qeveritar në këtë debat.

Korniza ligjore në Kosovë, i siguron të drejtat specifike personave që u përkasin këtyre komuniteteve. Strategjia për integrimin e komuniteteve, rom, ashkali dhe egjiptian dhe plani gjegjësisht i veprimit për zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, paraqesin në hollësi sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Bashkimi Evropian gjithmonë ka dalë me rekomandime që komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, janë komunitetet të marginalizuara në Kosovë, mjerisht kjo qëndron. Për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit, ka mungesë të vullnetit politik.

Në shumë fusha, kërkohet përkushtim më i fuqishëm i institucioneve qendrore dhe atyre lokale për t'i përmbushur standardet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare. Edhe pse janë bërë disa

hapa nga institucionet e Kosovës, zbatimi i strategjisë dhe plani i veprimit, mbetet i dobët për mos me thënë se nuk është bërë asgjë.

Në vazhdim ai u fokusua në elaborimin e propozim-rekomandimeve të paraqitura nga propozuesi për këtë debat.

Diskutimet e deputetëve: Xhevdet Neziraj, Elmi Reçica, Armend Zemaj, Albana Gashi, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Jasmina Zhivković, Albert Kinolli dhe Etem Arifi, janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Danush Ademi, Lumnije Morina, Glauk Konjufca, Vjollca Krasniqi, Shaip Muja, Sadri Ferati, Alma Lama, Muhamet Mustafa, Halit Krasniqi, Teuta Haxhiu dhe Xhevdet Neziraj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Shaip Muja kërkoi që propozim-rekomandimet e paraqitura nga deputeti Xhevdet Neziraj, të harmonizohen me të gjitha grupet parlamentare.

Në vazhdim kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum dhe nuk mund të procedohet me votim të propozim-rekomandimeve.

* * *

Më pas, deputeti Sadri Ferati propozoi që pika nr. **13. Debat parlamentar lidhur me rirregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave**, të shtyhet për mbledhjen tjetër, me arsyetim se asnjëri nga ministrat e Kabinetit qeveritar nuk ishin të pranishëm në sallë.

Në lidhje me propozimin e lartpërmendur u deklaruan përfaqësuesit e grupeve parlamentare, si në vijim: Shaip Muja – PDK, Glauk Konjufca – “Vetëvendosje”, Burim Ramadani – AAK, Myzejene Selmani – KKR, Sasha Milosavleviq – SLS, Albert Kinolli – “6+”, Milivoje Stojanović – ‘ZB’.

Kuvendi miratoi propozimin e paraqitur nga deputeti Sadri Ferati.

* * *

Kryesuesi konstatoi se për vazhdimin e mbledhjes plenare të sotme vendos kryesia e Kuvendit në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, që do të mbahet më 10 qershor 2013.

Ai i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 14:25 minuta.

* * *

*E enjte, më 13 qershor 2013
Vazhdimi i mbledhjes plenare*

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI** ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 6 e 7 qershor 2013.

Ai procedoi me votim për pikat si në vijim:

1. Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012

Kryesuesi hodhi në votim raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 33,
Kundër----- 29,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2012.

2. Votimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për vitin 2012

Kryesuesi hodhi në votim raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 40,
Kundër-----16,
Abstenime----- 9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2012.

3. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012

Kryesuesi hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 47,
Kundër-----15,
Abstenime----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2012.

4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009- 2015

Kryesuesi hodhi në votim propozim-rekomandimet e deputetit Xhevdet Neziraj, nga debati parlamentar lidhur me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi rekomandimet nga debati parlamentar lidhur me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, nxori këto:

REKOMANDIME

1. Problemet dhe nevojat e komunitetit egjiptian të Kosovës të mos adresohen nëpërmjet dokumentit “Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015”, si dhe të ndryshohet emërtimi dhe përmbajtja e dokumentit, duke mos e përmendur asnjëherë komunitetin egjiptian.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë masa për ngritjen e nivelit të arsimit në të gjitha nivelet e arsimit nëpërmjet hartimit të programeve të veçanta të subvencionimit të nxënësve dhe studentëve dhe për punësimin e të kualifikuarve.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës ta planifikojë një shumë të caktuar nga Buxheti i Kosovës për çdo vit për financimin e projekteve të infrastrukturës në vendbanimet ku është i përqendruar komuniteti egjiptian.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë masa në zbatimin e Ligjit të Shërbimit Civil dhe udhëzimeve administrative që burojnë nga ky ligj, e që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal dhe qendror.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë masa të veçanta, ashtu siç parashihet edhe në Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve për punësim në Policinë e Kosovës, në Doganat e Kosovës, FSK dhe në ndërmarrjet publike.
6. Të sigurohet qasje e barabartë me komunitetet tjera në mediumet publike në Kosovë.

5. Debat parlamentar lidhur me rirregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave

Deputeti Ramiz Kelmendi, i mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015.

Kryesuesi e ftoi deputetin Ramiz Kelmendi që, në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Ramiz Kelmendi, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, tha se sot e kam ngritur një çështje për debat parlamentar për rirregullimin apo heqjen e taksave të sigurimit të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave, kërkesave të shumta të bashkëkombësve

tanë nga trevat jashtë Kosovës, bashkëqytetarët që jetojnë dhe punojnë në diasporë dhe qytetarë tjerë që dëshirojnë të qarkullojnë nëpër territorin e Republikës së Kosovës si destinacion të vizitave familjare dhe turizmit.

Automjetet e shteteve të huaja që kalojnë nëpër Kosovë posedojnë kartonë të gjelbër, të pranuar ndërkombëtarisht, por Kosova ende nuk është bërë pjesë e Kombeve të Bashkuara dhe ne kemi vendosur tarifa të caktuara të vlerave financiare sipas llojit të automjetit dhe peshës bartëse për t'i mbrojtur makinat dhe personat nga dëmet që mund të shkaktojnë këto makina në territorin e Republikës së Kosovës.

Ne si deputetë, me këtë propozim, nuk kemi qëllim t'i dëmtojmë kompanitë e sigurimit, por që ato taksa të ndahen në taksa një ditore, pra, që vlerat e njëjta të sigurimit të jenë të ndara për ditë të qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës.

Duke e ditur se po fillon sezoni turistik në Republikën e Shqipërisë, edhe qytetarët e Luginës së Preshevës, apo qytetarët tjerë të cilët kalojnë transit në Kosovë, u duhet të paguajnë minimum 20 euro për shkuarje dhe 20 euro për kthim, pra gjithsej 40 euro sigurime.

Vend të veçantë zënë edhe sigurimet e automjeteve për diasporën tonë. Edhe këtë mund ta rregullojmë që siguri i paraparë vjetor, të paguhet për numrin e ditëve të planifikuara se sa do të qëndrojnë në Republikën e tyre të Kosovës.

Deputeti Ramiz Kelmendi më pas tha se kanë propozuar një rekomandim që taksa e sigurimit për automjetet e udhëtarëve dhe automjeteve për mallra që e kanë destinacion Republikën e Kosovës dhe transitin nëpër të rirregullohet në atë mënyrë, që shuma e përcaktuar të pjesëtohet për numrin e ditëve dhe shuma ditore e qëndrimit të jetë e shumëzuar për numrin e ditëve sa do të qëndrohet.

Ai në fund kërkoi nga deputetët miratimin e këtij propozim-rekomandimi.

Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se Lugina e Preshevës është preokupim yni gjithmonë dhe kufijtë që na ndajnë sot duhet të jenë ura bashkimi dhe bashkëpunimi që ta ndërtojmë në rrugëtimin tonë bashkëkohor, politik dhe kombëtar.

Por, Kosova aktualisht nuk është pjesë e sistemit të kartonit të gjelbër, pasi neni 4.2 i Kushtetutës së Këshillit të Byrove thekson se një byro, e cila synon të anëtarësohet në atë Këshill duhet të jetë byroja e një shteti, i cili është i njohur ndërkombëtarisht dhe është i anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Siguri i kufitar i autopërgjegjësive është siguri, i cili është i obliguar me ligj për të gjitha mjetet motorike me tabela të huaja, të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, përveç Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Maqedonisë, shtete me të cilat Kosova ka nënshkruar memorandum të bashkëpunimit për njohje reciprociteti të sigurimeve.

Aktualisht, sipas LS, DAP, në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve ekziston fondi i kompensimeve, i cili administrohet nga byroja dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve që ndodhin në territorin e Kosovës.

Kompanitë e sigurimeve janë të detyruara të kontribuojnë në fondin e kompensimeve çdo tre muaj, në varësi të pjesëmarrjes së tyre në treg për produktin TPL për tremujorin paraardhës.

Nëse përjashtohet polica e sigurimit kufitar për automjetet me targa të huaja, të cilat hyjnë në Kosovë, shtrohet pyetja e kompensimit të dëmit që sipas LS, DAP, sipas nenit 13, për persona kap shumë 1 milion euro, pavarësisht nga numri i personave të lënduar.

Nga do të grumbullohen këto mjete, a kanë detyrim ligjor kompanitë e sigurimeve të paguajnë dëme për diçka që nuk është regjistruar si e hyrë, theksoi në fund deputeti Lladrovci?

Hashim Dëshishku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha çështja e sigurimit kufitar është një problem i rëndë, i cili krijon kosto shtesë për ata që i kanë targat e automjeteve të shteteve tjera, e që nuk kanë marrëveshje me Kosovën. Kjo i ngarkon, si individët, ashtu edhe bizneset e jashtme dhe vendore, ndërsa si ilustrim ai përmendi se vitin e kaluar, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, kompanitë e sigurimeve kanë shitur 355 mijë polica

kufitare, prej të cilave kanë argëtuar 14 milionë e 700 mijë euro. Kjo shumë është në rritje për çdo vit.

Se vërtet kjo taksë e ka vështirësuar qarkullimin e mallrave dhe të qytetarëve, apo po krijon kosto shtesë për ata, tregon sidomos rasti i Gjilanit, ku ekonomia dhe tregu i këtij qyteti, ka qenë ngushtë e lidhur me konsumatorët nga Presheva, Bujanoci, madje edhe nga Vranja.

Sipas deklaratave të përfaqësuesit të bizneseve nga Gjilani, tash këta blerës janë orientuar kah Kumanova apo qytetet tjera të Maqedonisë, ku nuk janë të ngarkuar me taksa kufitare, sepse të dy shtetet e kanë kartonin e gjelbër, theksoi deputeti Dëshishku.

Problemi i Kosovës është specifik dhe buron nga fakti se ajo nuk është anëtare e Byrosë Ndërkombëtare të Kartonit të Gjelbër, e këtë status nuk mund ta ketë, përderisa nuk është anëtare në organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Është edhe një alternativë tjetër, për të cilën asnjëherë nuk është biseduar, ka mundësi që kosovarët që vijnë nga diaspora, apo shqiptarët që jetojnë në Kosovën Lindore në kufi të pajisen me dokument për sigurimin e automjetit të tyre, i vlefshëm vetëm brenda territorit të Kosovës, por pa paguar asgjë. Në këtë rast ai që e merr një vendim të tillë duhet ta gjejë zgjidhjen për ta krijuar mbulesën financiare për policat e lëshuara.

Në fund ai theksoi se zgjidhja më e mirë është përsheptimi i angazhimit për anëtarësimin në Byronë e Kartonit të Gjelbër, madje këtu të analizohen edhe përvojat e vendeve të tjera në botë, të cilat e kanë pasur kartonin e gjelbër para se të anëtarësohen në OKB, siç ka ndodhur me Kroacinë, ose në të kundërtën të arrijnë marrëveshje bilaterale me shtetet për njohjen e policës së sigurimeve.

Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” tha se ekzistenca e taksës së sigurimit për automjetet e udhëtarëve në formën se si aplikohet tani mbetet demotivuese për shumikënd që dëshiron të udhëtojë nëpër Kosovë, apo që dëshiron të qëndrojë pak më gjatë brenda shtetit të Kosovës.

Ndonëse mbetet e paqartë se cilës instancë i drejtohet ky rekomandim, mbetet përsëri fakti se kjo taksë, apo siç njihet ndryshe polica e sigurimeve, është me pasoja negative, veçanërisht për bashkatdhetarët tanë që dëshirojnë t’i kalojnë pushimet vjetore pranë bashkë familjarëve të tyre, apo edhe për bashkëkombësit tanë nga rajoni i Preshevës, Medvegjës apo Bujanocit.

Që Kosova ta fitojë të drejtën për kartonin e gjelbër duhet ta bëjë së paku një kërkesë. Mirëpo, siç thonë shumë ekspertë të kësaj fushe përkatëse, janë pikërisht kompanitë private të sigurimeve dhe aksionarët e tyre, të mbështetura nga institucionet qendrore të Kosovës, që nuk kanë kurrfarë interesi që të aplikojnë për karton të gjelbër.

Vetë fakti se nuk kemi të pranishëm asnjë përfaqësues të Qeverisë, ministër nga Kabineti qeveritar e tregon indolencën e tyre për ta zgjidhur këtë çështje dhe mos brengosjen e tyre për këtë taksë.

Prandaj, do të ishte mirë që sot, pasi po diskutojmë për këtë çështje, që të paktën qytetarët e Kosovës, si edhe bashkëqytetarët tanë që jetojnë jashtë shtetit do të ishin informuar se deri ku ka arritur ky proces, a janë zhvilluar këto kontakte dhe a ka ndonjë zgjidhje konkrete me këtë rast, theksoi deputeti Kasolli?

Gjykuar në bazë të fakteve, mbetet më se e qartë se edhe më tej secili mërgimtar që vjen për pushime në Kosovë, do të paguajë dy herë për sigurimin e automjeteve, një herë në vendin prej nga vjen dhe herën tjetër për kohën e qëndrimit në Kosovë.

Prandaj, shihet qartë se shteti i Kosovës ka interes konkret ta mbajë këtë taksë, në mënyrë që ta mbushë një pjesë të buxhetit nga vjelja e saj. Është kjo logjikë tipike e një pushteti, që praninë e tij e manifeston vetëm si tagër, si instancë marrjeje, mekanizëm për përvetësuar vjelje financiare të bashkëkombësve, imponon detyrime ndaj tyre, por nuk shpërndan asnjë të drejtë.

Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fillimisht tha se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk kërkon heqjen e taksës, por zvogëlimin e saj konform shërbimit që

ofrohet nga kompanitë e sigurimeve. Shumë thjesht, nëse një bashkatdhetar ose një qytetar i Preshevës, Medvegjës, Bujanocit futet, në Kosovë dhe vjen për vikend, nuk është e drejtë që ai ta paguajë qëndrimin e tij për një muaj, respektivisht kompania nuk mund të marrë përgjegjësi për kohën sa personi në fjalë nuk gjendet fare në Kosovë e kjo po ndodh.

Dhe, në emër të Aleancës, sot i kisha ftuar deputetët që të mos pretendojnë që po thirremi në ligj, sepse nuk është e ligjshme që kompania të marrë përgjegjësi për kohën kur automjeti ose qytetari nuk gjendet fare në Kosovë, por të paguhet për shërbimin për çdo ditë. Domethënë, kjo është kërkesa, jo të hiqet, por të shkohet konform shërbimit dhe të minimizohet.

Prandaj, sot kisha dashur edhe një herë të them që ky Kuvend të marrë në fakt vendim në të mirë të qytetarëve nga diaspora, të cilët i përmendim aq shumë, dhe ta ulë taksën konform shërbimeve që u ofrojnë kompanitë, me qëllim që në fakt, diasporën të mos e shfrytëzojmë veç për fushata elektorale, por të bëjmë edhe veprime konkrete në periudhat kur ata do të vijnë në Kosovë. Dhe, fakti që ata shumë shpejt do të vijnë në Kosovë, mendoj që nga kjo seancë sot duhet të dalë një qëndrim dhe një vendim unanim që kjo taksë të ulet.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se do të ishte mirë që dikush prej Kabinetit qeveritar të ishte këtu e të sqarojë para deputetëve se çështja është politike dhe çështja e kompanive të sigurimeve është çështje e kompanive, të cilat janë gati 90 sosh, të cilat nuk janë kosovare, por janë kompani të huaja që kanë ardhur, kanë investuar në Kosovë dhe kjo çështje duhet të rregullohet në bazë të politikave të BQK-së dhe politikave të cilat duhet të dalin nga BQK-ja dhe nga Qeveria.

Mirëpo, të gjithë jemi në dijeni se Kosova ka marrëveshje me Malin e Zi dhe me shtetet tjera, siç është Shqipëria dhe kemi taksa tjera, ndërsa çështja me Serbinë dhe çështja e mërgimtarëve do të jetë çështje, e cila besoj që do të rregullohet shumë shpejt, jo vetëm me fjalë, por të rregullohet me vepër.

Ndërsa, çështja e qytetarëve shqiptarë që hyjnë nga Republika e Serbisë në Kosovë duhet të zgjidhet me një marrëveshje. U tha edhe nga deputeti i LDK-së që Kosova nuk ka marrëveshje me Serbinë dhe për këtë arsye janë këto lloj të sigurimeve kufitare dhe shpresojmë që shumë shpejt edhe BQK-ja, edhe Ministria e Financave, do të bëjnë një zgjidhje të duhur në favor të qytetarëve të Kosovës.

Petar Miletij, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se për çështjen për të cilën sot po debatojmë, do të duhej që zyrtarët e institucioneve të Kosovës të jenë në nivelin e përgjegjësive për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

Në vazhdim ai theksoi se problemet e ndryshme të pazgjidhura të natyrës administrative ndërmjet Prishtinës e Beogradit, tani sikur po zëvendësohen me probleme të natyrës financiare, ndërsa nga situata momentale e sigurimit të automjeteve për qytetarët e huaj përfitojnë vetëm kompanitë e sigurimeve në të dy vendet, me theks ato në Kosovë dhe Serbi, duke arritur një profit shumë më të lartë se biznesi i njëjtë në cilindo shtet të Evropës. Andaj, mbetet në dorën e institucioneve relevante që këtë çështje ta zgjidhin në interes të qytetarëve, në atë mënyrë që të tregojmë se integrimi i Kosovës në Evropë nuk është çështje e fjalimeve demagogjike, por as e parullave politike.

Në fund ai theksoi se do t'i përkrahë propozim-rekomandimet lidhur me këtë debat.

Mufëra Shinik, në emër të Grupit Parlamentar "6+", tha se mbështet deputetët të cilët e kanë iniciuar debatin në lidhje me automjetet me regjistrim të huaj dhe udhëtarët që vijnë nga jashtë në Kosovë, si dhe kamionët me mallra, të cilët me rastin e hyrjes në Kosovë janë të obliguar që ta paguajnë taksën shtesë.

Milivoje Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar ZB tha se në vend që qytetarëve t'u krijojmë lehtësira për lëvizjen e lirë të tyre, në fakt është krijuar një barrierë lidhur me tarifat e

policave të sigurimit të automjeteve, të cilat ata duhet t'i paguajnë me rastin e hyrje-daljeve, me theks në kufirin Kosovë-Serbi.

Përderisa në Evropë dhe në regjion, hiqen pengesat dhe shkaqet, të cilat pengojnë lëvizjen e lirë të njerëzve, tek ne çështja e sigurimit të automjeteve është bërë pengesë e llojit të vet.

Më tej, ai theksoi se do të duhej që në afatin më të shkurtër të mundshëm, të arrihej marrëveshja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, në mënyrë që qytetarët të mos detyrohen të paguajnë sigurime të dyfishta për mjete motorike dhe në këtë mënyrë të kontribuojmë më shumë në lirinë e lëvizjes dhe qarkullimin e mallrave.

Grupi parlamentar që përfaqësoj, propozon që të gjitha automjetet që kanë kartonin e gjelbër, të mund të hyjnë në territorin e Kosovës, pa pagesë të taksës shtesë të sigurimeve.

Diskutimet e deputetëve: Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Hashim Deshishku, Afrim Kasolli, Donika Kadaj-Bujupi, Myzejene Selmani, Petar Miletqi, Mufera Shinik dhe Milivoje Stojanoviq janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Emin Gërbeshi, Nijazi Idrizi, Teuta Haxhiu, Halit Krasniqi, Sadri Ferati, Nait Hasani, Emilija Rexhepi, Hydajet Hyseni, Muhamet Mustafa, Xhavit Haliti, ministri Besim Beqaj, Ismet Beqiri, Ramiz Lladrovci, Ardian Gjini, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, deputeti Ramiz Kelmendi ia paraqiti Kuvendit, propozim-rekomandimin lidhur me debatin e sotëm dhe kërkoi që i njëjti të votohet.

Deputeti Adem Grabovci, kërkoi që propozim-rekomandimet e paraqitura nga deputeti Ramiz Kelmendi, të harmonizohen me të gjitha grupet parlamentare.

Në fund, kryesuesi konstatoi se propozim-rekomandimi i paraqitur nga deputeti Ramiz Kelmendi, do të duhej të harmonizohej me të gjitha grupet parlamentare dhe të procedohet me votim në mbledhjen plenare të radhës.

* * *

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale